



AMERICAN CHAMBER OF COMMERCE
DHOMA AMERIKANE E TREGTISË

07 prill 2024

Nr. 10 prot.

Drejtuar: Znj. Belinda Balluku
Ministër
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Rr. "Abdi Toptani", Nr. 1, 1001
Tiranë

Znj. Adelajda Roka
Drejtore të Përgjithshme
Agjencia e Zhvillimit të Territorit
Rr. Themistokli Gërmenji, Pallati Frashëri, Kati II
Tiranë

Objekti: *Kërkesë për rishikim të tarifave të miratuara me vendimin nr. 428, datë 26.6.2024 "Për miratimin e tarifave dhe të mënyrës së përdorimit të tyre për shërbimet që kryhen nga sekretariati teknik i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit"*

E nderuar Znj. Ministre,

Dhoma Amerikane e Tregtisë në Shqipëri (në vijim referuar si "**Dhoma**"), duke patur në themel të misionit të saj të ndihmojë bizneset të punojnë në një klimë të qëndrueshme dhe me konkurrencë të ndershme ju drejtohet nëpërmjet kësaj letre për të tërhequr vëmendjen tuaj në lidhje me një çështje që prek një numër të konsiderueshëm të anëtarëve tanë.

Bëhet fjalë për biznese anëtare të Dhomes, që janë proces zhvillimi po synojnë të investojnë në ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë së rinovueshme apo vepra të tjera të infrastrukturës.

Me datë 26 qershor 2024 Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 428, "Për miratimin e tarifave dhe të mënyrës së përdorimit të tyre për shërbimet që kryhen nga sekretariati teknik i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit" ("VKM 428").

Objekti i VKM 428 është përcaktimi i tarifave për shërbimet, si dhe mënyra e përdorimit të tyre për aplikimet që janë kompetencë e Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit (në vijim "KKTU") dhe që ofrohen nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit (në vijim "AZHT"), në cilësinë e sekretariatit teknik të KKTU.

Sipas VKM 428, tarifat e vendosura "kanë për qëllim të mbulojnë vetëm shpenzimet për procedurat administrative që AZHT-ja kryen, pavarësisht nëse shërbimi i kërkuar nuk mund të realizohet për shkaqe të ligjshme, në përputhje me ligjin nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", dhe me legjislacionin sektorial në fuqi".

Për tarifat e shërbimeve që do të ofrohen nga AZHT, ndër të tjera, VKM 428 parashikon tarifën për shqyrtimin e kërkesave për pajisje me leje zhvillimi.

Më konkretisht, pika 4 e Vendimit parashikon se "Tarifa për shqyrtimin e kërkesave për leje zhvillimi do të llogaritet në bazë të sipërfaqes së pronave që do të zhvillohen dhe niveli i tarifës është në vlerën 100 (njëqind) lekë për m². Pagesa kryhet pas konfirmimit të vendimit të miratimit të lejes së zhvillimit nga Këshilli Kombëtar të Territorit dhe Ujit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga lëshimi i faturës nga AZHT-ja. Nga ky parashikim përjashtohen aplikimet për leje zhvillimi për centralet gjeneruese të energjisë, tarifa për shqyrtimin e të cilave do të llogaritet në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë për MW.

Duke referuar në legjislacionin shqiptar, konceptin e 'tarifës' e gjejmë në ligjin nr. 9975/2008 "Për taksat kombëtare", në të cilin parashikohet se: "Tarifë" është një pagesë, që një individ, person fizik apo juridik, bën drejtpërdrejtë apo nëpërmjet një agjenti tek administrata tatimore qëndrore. Pagesa bëhet në shkëmbim të një shërbimi specifik të marrë, të mirë publike specifike të përdorur apo të drejte të dhënë". Thënë kjo, tarifa nënkupton një pagesë që bëhet kundrejt marrjes së një shërbimi apo një të drejte që ofrohet nga organet e administratës, apo autoritetet e përcaktuara sipas ligjit.

Meqënëse synimi kryesor i administratës publike është ofrimi i shërbimeve për publikun dhe jo realizimi i fitimit, rezulton se niveli i tarifës duhet të orientohet në mbulimin e kostos së shërbimit publik të ofruar. Për më tepër, tarifa për shërbimet publike, duhet të vendoset për një përfitim që është i matshëm për përdoruesit apo përfituesit, duke përdorur instrumente të përshtatshme për të siguruar aksesin, cilësinë, sasinë dhe koston e përbalueshme nga të gjithë.

Nga disa përlllogaritje të bëra nga anëtarët tanë që operojnë tashmë ose synojnë të operojnë në fushën e prodhimit të energjisë së rinovueshme rezulton se niveli i tarifës për shqyrtimin e lejes së zhvillimit, nuk është në përputhje dhe proporcionale me koston reale të shërbimit të ofruar dhe është shumë më i lartë sesa tarifat që aplikohen në vende të tjera të Europës.



AMERICAN CHAMBER OF COMMERCE
DHOMA AMERIKANE E TREGTISË

Për sipërmarrësit vendas ashtu dhe për investitorët e huaj, të cilët zhvillojnë projekte në fushën e energjisë së rinovueshme, tarifa në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë për MW, përbën një barrë të konsiderueshme financiare. Për më tepër, për ata subjekte që tashmë kanë kryer studimin e fizibilitetit dhe janë gati për të finalizuar dokumentacionin për aplikim për leje zhvillimi, niveli i tarifës i vendosur me VKM 428 ka tejkaluar çdo parashikim në buxhet për tarifën e zhvillimit të projektit.

Tarifa për lejen e zhvillimit dhe ajo për lejen e ndërtimit në projekte të prodhimit të energjisë zë pjesën më të madhe të shpenzimeve të fazës përgatitore (para-operimit) të projekteve (mbi 90% të këtyre shpenzimeve), në një masë shumë më të lartë sesa tarifën e aplikimit në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, autoritetet mjedisore, AKBN apo taksa e ndikimit në infrastrukturë që paguhet pranë qeverisjes vendore. Kjo bën që shpenzimet para-operimit në një projekt në Shqipëri të arrijnë deri në rreth 22.000 Euro për një MW, ndërkohë që në Rumani apo Bullgari ato janë në nivelin prej 4.800 deri 8.500 Euro për MW dhe në Serbi rreth 750 Euro për MW.

Ne jemi të vetëdijshëm për rëndësinë e rregullimit të të ardhurave nga shërbimet publike, por përcaktimi i tarifave në nivele të larta paraqet pengesa thelbësore në rritjen ekonomike dhe investimet në rajonin tonë. Kjo nuk vlen vetëm për fushën e energjisë së rinovueshme, por është një çështje shqetësuese edhe për kompani të tjera të përfshira në sektorin e ndërtimit – në thelb, për të gjitha projektet infrastrukturore.

Nëse i referohemi gjithashtu politikave për investimet strategjike dhe më konkretisht në sektorin e energjisë, vihet re se në fokus të tyre kanë nxitjen dhe tërheqjen e investimeve strategjike nëpërmjet krijimit të lehtësirave administrative, skemave mbështetëse, etj. Në këndvështrimin tonë, rishikimi i tarifave do të sillte padyshim lehtësim të këtij procesi, duke qënë kështu në një linjë me politikën shtetërore dhe kuadrin rregullator për investimet strategjike.

Sa më sipër, parashikimi i detyrimeve financiare të vendosura me VKM-në nr. 428, paraqet një sfidë për të gjithë investitorët në sektorin e energjisë dhe jo vetëm. Barra financiare fillestare e tarifave të fazës para-operimit, e kombinuar me tarifën e tjera, vështirëson aftësinë e investitorëve për të vlerësuar fizibilitetin financiar të këtyre projekteve para se të sigurojnë financimin.

Qëllimi i rishikimit të tarifave të vendosura me VKM 428 duhet të jetë për të identifikuar një qasje të balancuar që siguron marrjen e shërbimit nga njëra anë dhe duke promovuar një mjedis miqësor ndaj sipërmarrësve dhe investitorëve nga ana tjetër.

Ne besojmë se adresimi i kësaj çështje, do të krijojë një klimë më të favorshme investimi, duke nxitur kështu rritjen ekonomike dhe zhvillimin në vendin tonë.

Do të dëshironim që këtë çështje të diskutojmë më tej në një takim me ju, nëse axhenda juaj do ta mundësonte.

Mbetemi në pritje të informacionit tuaj në lidhje me datën e mundshme të takimit.

Me respekt

Neritan Mullaj

Drejtor Ekzekutiv

